



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:005001

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06321468

C.nr.150/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J. B. nga Komuna e Obiliqit, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve K. Nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës, me datë 18.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit J. B. nga Komuna e Obiliqit dhe DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 12.03.2020-21.11.2022, për 628 ditë, t’ia paguajë shumën prej 439.60, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 04.01.2023 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Paditësi J. B. përmes të autorizuarit të tij, me datë 04.01.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e 70% të shpenzimeve të transportit rrugor, me kamatë ligjore.

Paditësi padinë e tij e ka precizuar në aspektin objektiv me parashtrësën e datës 06.06.2024

Në padi dhe në parashtrësën për precizimin e padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHMLP /në Obiliq. Më tutje ka shtuar se paditësit në bazë të Kontratave Kolektive të Arsimit i takon kompensimi i 70% të transportit rrugor (vajtje-ardhje, 1.00 euro) për çdo ditë të pranisë në punë, përkatësisht për 628 ditë pune për periudhën 12.03.2020 – 21.11.2022 në vlerë prej 439.60 euro.

Shpenzimet i ka kërkuar, dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, 21 euro për taksë gjyqësore dhe 104 euro për parashtrësën për ndryshimin e padisë, plus 18% TVSh.

E paditura, me datë 28.08.2024 ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për arsye se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive në të cilën e bazon kërkesëpadinë Paditësi, e rrjedhimisht kjo kontratë nuk mund të ketë implikime financiare për të paditurën, por vetëm për palët nënshkruese. Ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar padia e paditësit për shkak se nuk i përmban elementet e domosdoshme të një padie. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe të përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, po ashtu gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, andaj pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret rezulton se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës “punëtor teknik” në SHMLP /në Obiliq. Këtë fakt, edhe pse jokontestues, gjykata e vërtetoi nga Kontrata e punës, e datës 01.09.2022 e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës.

Po ashtu, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë prezent në punë nga data 12.03.2020 e deri me datë 21.11.2022 dhe gjithsej ka 628 ditë pune, e që po ashtu i njëjti është me vendbanim në Carovodicë, Komuna e Obiliqit dhe se ka udhëtuar për ditët e punës deri në vendin e tij të punës në Obiliq dhe çmimi i biletës dy drejtimesh ishte 1.00 euro. Kjo gjendje faktike edhe pse jokontestuese, u vërtetua dhe nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit 808/2, i datës 18.03.2024 i lëshuar nga SHMLP /në Obiliq; Certifikata e vendbanimit e datës 09.12.2022 e lëshuar nga Z.Gj.C. Obiliq dhe Vërtetimi për vitin 2024, lëshuar nga kompania transportuese “Durimi” Sh.P.K.

Në rastin konkret lidhur me bazën e kërkesëpadisë duhet të zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë (KKAK) e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj, e deri me datë 21.01.2021, si dhe për periudhën pas kësaj date duhet të zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë (KKAK) e datës 22.01.2021.

Neni 2, paragrafi 1 i KKAK-së përcakton se: “Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, filllore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]” Ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës

Po ashtu, me nenin 35, paragrafi 5 të KKAK-së, parashihet se “Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”,

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t'ia paguajë paditësit kompensimin për shpenzimet e rrugës 70% të biletës së trafikut urban. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 35, paragrafi 5 të KKAK-së.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit shpenzimet e rrugës mori për bazë vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit 808/2, i datës 18.03.2024, i lëshuar nga SHMLP /në Obiliq, sipas së cilit paditësi nga data 12.03.2020 e deri me datë 21.11.2022 dhe gjithsej ka 628 ditë pune si dhe vërtetimin nga kompania transportuese "Durimi" ShP.K. që vërteton se çmimi i biletës për vajtje-ardhje në punë e paditësit ishte 1.00 euro, e që 70% e çmimit të biletës së trafikut është e barabartë me shumën prej 439.60 e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës të parashtruara në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për refuzimin e kërkesës së paditësit, për shkak se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) dhe e njëjta do të llogaritet në shumë e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 124.00 €, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore. Ndërsa, gjykata nuk e detyroi të paditurën që paditëses t'ia paguajë edhe shumën prej 122 euro në emër të parashtrësës për precizimi e padisë, dhe shtesën për TVSH, pasi që paditësi me fajin e tij nuk e ka paraqitur padinë të rregulluar që nga fillimi, ndërsa shtesa për TVSH nuk është e paraparë në Tarifën e Odës së Avokatëve.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.150/23, datë 18.10.2024

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.